



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Date: 13/06/2025

Nr.02/633

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), që vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Komunës së Shtimes, me qëllim të realizimit dhe funksionalizimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, Kryetari i Komunës së Shtimes merr këtë:

VENDIM

1. Formohet Komisioni për pranimin e praktikanteve në kuadër të realizimit të aktiviteteve që dalin nga Marrëveshja e Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), që vepron në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe Komunës së Shtimes.
2. Personat e emëruar si anëtarë të komisionit sipas pikës së parë të këtij vendimi janë:
 1. Remzie Zeqiri- Kryesuese
 2. Armend Imeri- Anetar
 3. Valmira Hoxha- Anetare
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit bazohen në praktikat e funksionimit standard e profesional institucional në funksion të ligjshmërisë, transparencës dhe efikasitetit.
4. Mandati i këtij Komisioni zgjat deri në përfundimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit sipas pikës së parë të këtij vendimi, konkretisht më 16.12.2025.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim:

Ky Vendim merret me qëllim të krijimit të mekanizmave funksionalë për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes APRK-së dhe Komunës së Shtimes

Kryetari i Komunës
Z. Qemal Aliu